



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Numri i Ceshtjes : 61005-01011-11-2017 **Data e Regjistrimit :** 09/07/2017
Numri i Vendimit: 11-2017-3549 **Data e Vendimit :** 11/07/2017

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: Petraq Çuri

SEKRETARE: Eriola Gashi

Sot më datë 11/07/2017mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

Objekti:Kerkese per vleftesim te ligjshem te arrestimit dhe caktim mase sigurimi personal ate te "Arrestit ne burg" ndaj shtetasit Alket Hatija per qëllim ekstradimi.

Baza Ligjore:Neni 493 e vijues i K.Pr.Penale.

Gjykata pasi shqyrtoi në tërësi çështjen dhe pasiadministroi provat dhe aktet e ndodhura ne dosje, degjoi :

Prokurorin i cili, kërkoi pranimin e kërkesës;

Mbrojtësin,që kërkoi rrëzimin e kërkesës.

Të arrestuarin, i cili kërkoi sipas avokatit.

VEREN :

Vëren:Prokuroria e RrethitGjyqësor Durrës, me kërkesën e saj datë 09.03.2017 ka sjellë për gjykim të arrestuarinAlket Hatija,me objekt:

1.Miratimin e “arrestimit” të datës 08.07.2017 tështetasit Alket Hatija.

2.Caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”për shtetasin Alket Hatija,me qëllim ekstradimi konformë dispozitave ligjore nëItali.

Konstatohet se çështjaështë në juridiksionin gjyqësor dhe kompetente për gjykimin e saj është Gjykatae Rrethit Gjyqësor Durrës.

Ngjarjaka ndodhur në këto rrethana:

I arrestuari Alket Hatija, është banor i qytetit Durrësit.

Në kërkesën esaj,Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, arsyeton se nga Drejtoria eMarëdhënieve Juridiksionale me Jashtë,përmes shkresës me nr.768/1(G.K) datë 08.07.2017,ështëpërcjell kërkesa për “Arrestimin dheekstradimin nga Shqipëria në Itali” të shtetasit Alket Hatija.

Rezulton se shtetasi AlketHatija, ndodhet i arrestuar për efekt se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës,ka vendosur arrestimin e tij tëpërkohshëm me datë 08.07.2017 ora 11.30’,mbasi me vendimin nr.4526/2015 datë30.09.2015 të Gjyates së Milanos, është dënuar me 20 vjet burgim, për veprënpenale te “Trafikimit të narkotikëve”.

Kjo prokurori kavendosur arrestin e tij mbasi sipas saj, ky shtetas është shpallur në kërkimndërkombëtar,përsa sipër mbështetur në Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisëdhe Republikës së Italisë,si dhe shtesëse Konventës Europiane për Ekstradimin të datë 13 dhjetor 1957 dhe e KonventësEuropiane për Ndihmë të Ndërsjelltë Juridike në Çështjet Penale ratifikuar meligjin 9871 datë 11.02.2008, si dhe nenet 493 e vijues të KPrP,kërkohetekstradimi i këtij shtetasi.

Neni 493 iKPrP,shprehet:

“Masatshtrenguese dhe sekuestrimet.

1.Me kërkesë tëMinistrisë së Drejtësisë,të paraqitur nëpërmjet prokurorit,ndaj personi përtë cilin është kërkuar ekstradimi mund të merren masa shtrenguese dhe tëvendoset sekuestrimi i provave materiale dhe i sendeve që i përkasin veprëspenale,për të cilën është kërkuar ekstradimi.

Kurse nenit 494 iKPP,shprehet:

“Zbatimii tëpërkohshëm i masave shtrenguese.

1.Me kërkesën e shtetittë huaj,të paraqitur nga Ministria e Drejtësisë nëpërmjet prokurorit pranëgjykatës kompetente,gjykata mund të vendosë tëpërkohësisht një masështrenguese para se të vijë kërkesa e ekstradimit.

.....”

Neni 495 i KPP,shprehet:

“1.Në rastet engutshme,policia gjyqësore mund të bëjë arrestimin e personit,kundër të cilitështë paraqitur kërkesa për arrestimin e tëpërkohshëm.Ajo bën edhe sekuestrimin eprovave materiale të veprës penale dhe të sendeve që i përkasin asaj.

2.Autoriteti që bënarrestimin njofton menjherë prokurorin dhe Ministrin e Drejtësisë.Brenda 48orëve prokurori e vë të arrestuarin në dispozicion të gjykatës në territorin esë cilës është bërë arrestimi,duke i dërguar edhe dokumentacionin përkatës.

3.Gjykata brenda 48orëve e miraton,atë,kur janë kushtet ose vendos lirimin e të arrestuarit.Përvendimin që merr ajo njofton Ministrin e Drejtësisë.

.....”

Gjykata vlerëson se nga ana e palës kërkueseProkurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës,paraqiti para gjykatës,dokumentacionin emëposhtëm:

-shkresa nr.768/1 protodatë 08.07.2017 e Prokurorisë së Përgjithshme(DMJJ).

-shkresanr.5734/Kl.prot/FKB1942/EK2017 datë 08.07.2017 të Ministrisë së Brendshme.

-ASF Kërkimnominal-raport individual për të arrestuarin i Interpolit.

Nga ana e mbrojtjes u paraqit:

-vendimi nr.10 datë26.03.2010 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.

Gjykata vlerëson se kërkesa e palës kërkuese Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, është e pabazuarligjërishit,për këto arsye:

1.Gjykata bazuar nënenin 493 të KPrP,konstaton se nuk ka një kërkesë të Ministrisë së Drejtësisësë RSH, lidhur me shtetasin Alket Hatija,për ekstradimin e tij në drejtim tëltalisë, e cila është detyruese në këtë rast.

2.Neni 494 i KPrP,kërkonqë gjithashtu të ekzistojë edhe kërkesa e shtetit të huaj, që në rastin konkretështë shteti italian, e cila nuk është e paraqitur nga pala kërkuese.

3.Nga mbrojtja eshtetasit Alket Hatija u ngrit një pretendim sipas të cilit Gjykata e Shkallësë Parë për Krimet e Rënda Tiranë me vendimin nr.10 datë 26.03.2010, e cila eka dënuar me 10 vjet e 8 muaj burgim për veprën penale të *“Trafikimit të lëndëve narkotike”* neni 283/a/2 të Kodit Penal.Vendimii dhënë nga Gjykata e Milanos, është për të njëjtin fakt penal, për të cilin kyshtetas është dënuar edhe në Shqipëri.

4.Për rrjedhojë nëkushtet kur nga ana e palës kërkuese nuk ka asnjë dokumentacion shtesë përveçatij të përmendur më sipas, gjykata vlerëson se arrestimi i këtij shtetasi nukështë i ligjshëm,mbasi mungojnë aktet bazë proceduriale për marrjen e një masetë tillë.

5.Kërkesa e paraqiturnga Prokuroria,kërkon që ndaj shtetasit Alket Hatija, të caktohet si masësigurimi *“arrest në burg”*,dukeparashtruar edhe arësyet pse duhet të caktohet një masë e tillë.

6.Gjykata duke jureferuar nenit 230 të KPP,konstaton se:

“1.Arresti në burg mundtë vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak tërrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit.

.....”

7.Gjykata vlerëson se nëkëtë rast janë shkelur të drejtat e të arrestuarit Alket Hatija, mbasi ai ka tëdrejtën e kontestimit të kësaj mase në rastse prej tij vlerësohet si e padrejtë.Gjykata vlerëson se në kushtet të tilla,ndaj tij duhet të aplikohet një masë sigurimi e cila nuk i cënon interesat etij, e konkretisht atë të *“Detyrimparaqitje para policisë gjyqësore”*,si një masë e cila i përgjigjet situatëskonkrete.

Për këto arsye

Baza Ligjore:Gjykata pasi pa dhe nenet228,232,234,493,494,495 e vijues të KPP;

VENDOSI:

Vendosi:

Të mosmiratojë *“arrestimin”* e datës08.07.2017 të shtetasit Alket Hatija.

Tëcaktojë si masë sigurimi personal për shtetasin Alket Hatija *“Detyrim paraqitje në Policinë Gjyqësore”*, tëhënën e parë e të tretë të çdo muaji nga ora 11.00-12.00,tek oficeri i policisëgjyqësore përkatëse.

Urdhërohettirimi i tij i menjëhershëm.

Një kopjevendimi t'i dërgohet Ministrisë së Drejtësisë,brenda afatit ligjor.

Kundërvendimit mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës,kyafat fillon nga dita e nesërme e shpalljes.

U shpall, në Durrës 11.07.2017.

SHPENZIMET GJYQESORE

Kërkesëpadia	0
Taksa Gjyqësore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:

Petraç Çuri